

VENDIM
Nr. 61, datë 1.2.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E BRENDSHME,
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE TË SHTETIT, TEK AUTORITETI
PORTUAL DURRËS, TË PASURISË SË PALUAJTSHME “ZONA E KARBURANTEVE”, NË
PORTIN E DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pikat 3 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 19 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2004 “Për Autoritetin Portual”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pronës publike, me sipërfaqe gjithsej 36 116,78 (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë, presje shtatëdhjetë e tetë) m² dhe të ndërtimeve të ngritura mbi të, me vendndodhje brenda territorit të Portit të Durrësit, e njohur me emërtesën “Zona e karburanteve” në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, në përgjegjësi të Autoritetit Portual Durrës, me sipërfaqe dhe planimetri sipas lidhjes së dhënë në aneksin nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, pa të drejtë vendosjeje barre siguroese, në kuptim të Kodit Civil dhe përjashtuar nga procedurat e shpronësimit në favor të të tretëve.

2. Pasuria e paluajtshme sipas pikës 1, me emërtimin “Zona e karburanteve”, t’i nënshtrohet përmirësimeve në dobi të zhvillimit të masterplanit, të miratuar me vendimin nr. 546, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit” dhe të zgjidhjeve efektive që rrisin rentabilitetin e portit.

Kostot e zbatimit të projektit të përballohen nga Autoriteti Portual Durrës.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Brendshëm, Autoriteti Portual Durrës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha